



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Dhjetor, 2024

01-31 Dhjetor, 2024

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit dhjetor 2023 dhe 2024
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT DHJETOR 2023 DHE 2024

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar **18,865 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1,058.57 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2023 (25,113 raste ose Inc 1,409.17 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 12,058 raste ose 676.61/100,000 banorë**, **Diarea akute me 4,157 raste ose 233.26/100,000 banorë**, dhe **ARI/ITPR me 1,869 raste ose 104.88 në 100,000 banorë (Tab.1)**.

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar 14 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 7 raste dg Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse, 5 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Meningitis meningococcica dhe 1 rast me Dg. Hepatit chr. B me diagnozë përcjellëse

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, DHJETOR 2024

Gjatë muajit dhjetor 2024 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit dhjetor 2024 në IKShPK janë raportuar 12,058 raste me ILI (Inc. 6176.61/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 21.72% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (15,404 raste) por krahasuar me muajin paraprak, nëntor 2024 me (10,887 raste të raportuara me ILI) vërehet, rritje prej 10.75% karakteristike për sezonën e dimrit.

Diarea akute: Gjatë muajit dhjetor 2024 në IKShPK janë raportuar 4,157 raste me Diare akute (Inc.233.26/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (6,076 raste), vërehet një rënie prej 31.58% dhe gjithashtu krahasuar me muajin nëntor 2024, me 4,726 raste të raportuara, vërehet rënie prej 12.03%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit dhjetor 2024 në IKShPK janë raportuar 1,869 raste me ARI (Inc.104.88/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (2,358 raste) vërehet një rënie prej 20.73% %, por krahasuar me muajin paraprak nëntor 2024 me (1,739 raste) të raportuara, rritje prej 7.47%, karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Variçella: Gjatë muajit dhjetor 2024 në IKShPK janë raportuar 478 raste me Variçellë (Inc.26.82/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 me (1,075 raste) vërehet rënie prej 55.53% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (519 raste), rënie prej 7.89%.

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë, 01 – 31 dhjetor të vitit 2023 dhe 2024

Tabela 1.

| Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë 01 - 31 dhjetor të vitit 2023 dhe 2024 | | | | |
|---|---------------|---------------------|---------------|---------------------|
| Sëmundjet/shkaktarët | Dhjetor, 2023 | | Dhjetor, 2024 | |
| | Nr. | Incidenca / 100,000 | Nr. | Incidenca / 100,000 |
| COVID-19 | 51 | 2.86 | 3 | 0.17 |
| ITPR - Pneumonia/ARI | 2358 | 132.31 | 1869 | 104.88 |
| SARI (forma e rëndë e pneumonisë) | 9 | 0.51 | 23 | 1.29 |
| Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI) | 15404 | 864.37 | 12058 | 676.61 |
| Influenca A | 11 | 0.62 | 78 | 4.38 |
| Influenca B | | | 7 | 0.39 |
| Human Adenovirus | 1 | | | |
| RSV | 7 | 0.39 | 37 | 2.08 |
| Diarea acute | 6076 | 340.94 | 4157 | 233.26 |
| Variçela | 1075 | 60.32 | 478 | 26.82 |
| Sindromi meningjeal | 13 | 0.73 | 14 | 0.79 |
| Helmimet me ushqim | 33 | 1.85 | 8 | 0.45 |
| Infeksionet tjera bakteriale me ushqim | | 0.00 | | 0.00 |
| Salmonella enteritidis | 1 | 0.06 | 2 | 0.11 |
| Gastroenterokolitet | 17 | 0.95 | 50 | 2.81 |
| Hepatiti akut B | 5 | 0.28 | 1 | 0.06 |
| Hepatiti akut C | | 0.00 | | 0.00 |
| Parotitits | | 0.00 | 3 | 0.17 |
| Pertussis | | 0.00 | 4 | 0.22 |
| Tularemia | 1 | 0.06 | 1 | 0.06 |
| Brucelosis | | 0.00 | 9 | 0.51 |
| Leptospirozë | 1 | | | |
| Leishmaniazë | 2 | 0.11 | | 0.00 |
| WNV | | 0.00 | | 0.00 |
| Sëmundja Lyme | 1 | 0.06 | 1 | 0.06 |
| Malarie ** | 1 | 0.06 | | |
| HIV/AIDS | 5 | 0.28 | 3 | 0.17 |
| IST | 23 | 1.29 | 12 | 0.67 |
| TB | | | 5 | 0.28 |
| Giardiaza | 8 | 0.45 | | 0.00 |
| MRSA | 1 | | | |
| Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus | | 0.00 | 13 | 0.73 |
| Cl.difficile | 2 | | 1 | |
| Infeksionet streptokoksike të grupit A | | | 5 | |
| Mpox ** | | | 1 | |
| *Sëmundjet tjera ngjitëse | 7 | 0.39 | 22 | 1.23 |
| Gjithsej | 25113 | 1409.17 | 18865 | 1058.57 |
| *Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza | | | | |
| ** Raste të importuara-Mpox, Malarie | | | | |

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:

Sëmundjet vaksinëpreventabile:

Nga ky grup i sëmundjeve gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar 4 raste të dyshimta me Pertussis (raste të dyshimta dhe të konfirmuara) si dhe 3 raste me Parotit epidemik (Tabela 1 dhe 2).. Nga gjithsej 29 raste të testuara si raste të dyshimta me Pertussis, nga laboratorit mikrobiologjik i IKSHPK-së janë konfirmuar 4 raste pozitive, prej të cilëve nga 4 rastet e kontaktuara, 3 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë (1 rast), Prizren (1 rast), Podujevë (1 rast) dhe Drenas (1 rast) . Sipas grup-moshës: 2-4 vjeç (2 raste) dhe 5-9 vjeç (2 rast). Sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 2 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Zoonozat dhe sëmundjet transmissive:

Gjatë muajit dhjetor nga ky grup i sëmundjeve janë testuar 85 mostra të dyshimta në Brucellozë dhe 32 mostra në Tularemi. Nga këto mostra të testuara në laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK, 9 kanë rezultuar pozitive në Brucellozë dhe 1 në Tularemi.

Rastet pozitive me Brucellozë sipas komunave: (5 raste Rahovec dhe me nga një rast komunat: Prishtinë, Viti, Pejë dhe Ferizaj), sipas grup-moshave 50-59 vjeç (4 raste), 40-49 vjeç (1 rast), 30-39 vjeç (2 raste), 20-29vjeç (1 rast) dhe 10-19vjeç (1 rast) dhe sipas gjinisë, 6 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 3 raste gjinisë femërore. Gjatë kësaj periudhe është raportuar një epidemi familjare me Brucellozë nga Rahoveci, me gjithsej 5 raste pozitive, familja në fjalë ka në pronësi një fermë me rreth 180 krerë dele, ku prej tyre 108 krerë dele janë asgjësuar nga inspektoriati veterinar i AVUK-it (shih pjesën epidemitë). Rastet tjera të konfirmuara me Brucellozë janë raste sporadike, 3 prej tyre si pasojë e kontaktit me kafshë (lopë, dele, dhi).

Gjatë muajit dhjetor 2024 është raportuar 1 rast me Tularemi (Skënderaj), rast sporadik i gjinisë mashkull, i grup-moshës 10-19 vjeç i raportuar nga zona endemike të cilët përdorin edhe ujin nga bunari.

Me datë 26.12.2024, nga Laboratori i Mikrobiologjisë-IKShPK përmes metodës rT-PCR është raportuar një pozitiv në Mpox. Rast i gjinisë mashkull i lindur më 1994 me vendbanim në Prishtinë, i hospitalizuar në Klinikën Infektive me datë 24.12.2024, me dg. Exanthema in obs. Nga hulumtimi epidemiologjik është kuptuar se rasti punon në Togo të Afrikës perëndimore dhe ka qëndruar nga data 26 gusht - 22 dhjetor 2024

Janë verifikuar të dhënat në lidhje me rastin si dhe është marrë lista e kontakteve që nga periudha e ardhjes në Kosovë. Gjatë gjurmimit janë kontaktuar të gjitha kontaktet e personit të infektuar dhe të familjarëve të tij, të cilëve u janë dhënë rekomandimet për masat e parandalimit dhe të kontrollit të infeksionit. Gjithsej janë gjurmuar 18 kontakte. (16 familjarë dhe 2 mjekë). Bazuar në obligimet e RrNSh pas konfirmimit të rastit me Mpox në vendin tonë, rasti është raportuar në OBSH.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve - Gjatë muajit dhjetor është raportuar një rast me malarie të importuar. Pacienti me vendbanim në Prishtinë, i gjinisë mashkullore që i takon grup moshës 40-49 vjeç, i cili për shkaqe profesionale në datat 28 nëntor - 1 dhjetor ka qëndruar në Etiopi, poashtu mohon të ketë marrë mbrojtje paraprake kundër malaries dhe deklaroi se ky është udhëtimi i tij i pestë në Afrikë në katër vitet e fundit.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit dhjetor, 2024 në IKSHPK janë raportuar 14 raste me Sindromë Meningjeale (Inc. 0.78/100 000 banorë). Krahasuar me periudhën e njejtë të vitit paraprak (13 raste), nuk vërehet ndonjë ndryshim në paraqitjen e rasteve, kurse krahasuar me muajin paraprak nëntor 2024 me (7 raste) të raportuara, vërehet rritje prej 100%.

Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë dhe Ferizaj me nga 3 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Fushë Kosovë, Gjakovë, Pejë, Drenas, Prizren dhe Shtime. Sa i përket grup- moshës, rezulton se grup- moshë më e prekur është 0-9 vjeç me (7 raste), 40-49 vjeç (4 raste), 20-29 vjeç (2 raste), 70-79 vjeç (1 rast) kurse grup moshat tjera me asnjë rast të raportuar. Sipas gjinisë, rezulton se të dyja gjinitë janë me numër të barabartë të paraqitjes së rasteve, gjinia femërore me 50% (7 raste) dhe gjinia mashkullore me 50% (7 raste). Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, në LCS janë izoluar: 3 raste me *Streptococcus pneumoniae*, 2 raste me *Hemophilus Influenzae* dhe HHV7 dhe me nga 1 rast, *Neisseria meningitidis*, *Escherichia Coli*, Mumps Virus, Human Enterovirus, Variçella Zoster Virus, B19 dhe HHV6. Gjatë këtij muaji është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningitis Meningococcicae fulminans, 1 vjeç, i gjinisë mashkullore nga Gjakova.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar 50 raste me dg. Gastroenterokolit, 8 raste me dg. Helmim me ushqim, Inc (0.45/100,000 banorë dhe 2 raste të dyshimta në Salmonelljanë raportuar (Inc.2.81/100,000 banorë) Tabela 1 dhe 2

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 11 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 9 raste Prishtinë dhe 2 raste Gjakovë. Sipas grup moshave 11 raste i takojnë grup moshës 0-4 vjeç, ndërkaq sipas gjinisë 8 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 3 rast gjinisë femërore, 1 rast me *Salmonella* Enteritidis nga komuna Prishtinës, i gjinisë mashkullore dhe takon grup moshës 60-69 vjeç, 1 rast me Adenovirus, nga komuna Prishtinës, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç, 1 rast me Norovirus, nga komuna Prishtinës, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast me *Clostridium difficile*, nga komuna Prishtinës, i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 60-9 vjeç.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit dhjetor 2024, u raportuan gjithsej 23 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV.

Rastet SARI sipas komunave janë Prishtinë (12 raste), Prizren (3 raste), Ferizaj (2 raste), Gjilan (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Drenas, Fushë Kosovë, Mitrovicë dhe Skenderaj. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është: mbi 80 vjeç (7 raste), 70-79 (5 raste), 50-59 (4 raste), 60-69 (3 raste), 40-49 (2 raste) dhe me nga 1 rast grup-mosha (20-29 dhe 30-39 vjeç)

Gjithsej 371 mostra të dyshimta në Influcencë janë testuar në laboratorin e Mikrobiologjisë-IKShPK. Prej tyre 85 raste pozitive në Influcencën A dhe B (22.9%). Me Influcencë A: 78 raste pozitive (21.02%) kurse me Influcencë B, 7 raste pozitive (1.8%). Rastet pozitive me Influcencë A dhe B, sipas komunave: Prishtinë 48, Fushë Kosovë 11, Vushtrri 6, Malishevë 5, Obiliq 3, Podujevë 3 dhe me nga 1 rast: Drenas, Ferizaj, Gjilan, Istog, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Rahovec dhe Skenderaj. Sipas grup moshes: 41 raste nga grup-mosha 0-4 vjeç, 16 raste nga grup mosha 5-14 vjeç, 14 raste nga grup mosha 15-34 vjeç, 4 raste nga grup mosha 35-50 vjeç, 5 raste nga grup mosha 51-64 vjeç, 5 raste nga grup mosha 65+.

Me RSV: 37 raste pozitive (9.97%), sipas komunave: Prishtinë 21, Podujevë 4, Lipjan 2, Skenderaj 2, Vushtrri 2 dhe me nga një rast komunat: Mitrovicë, Drenas, Fushë Kosovë, Gjakovë, Kaçanik dhe Prizren. Sipas grupmoshes: 31 raste 0-4, 3 raste 15-34, 2 raste 5-14 dhe 1 rast 65+.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 5 raste me TB, të cilat varësisht konfirmimit dhe strategjisë DOTS (terapisë së observuar direkte) do të përditësohen në buletin vjetor 2024. Gjithashtu nga Infeksionet e grupit A të Streptokokut janë raportuar 5 raste.

Rastet me HIV/AIDS/IST, dhjetor 2024

Gjatë muajit dhjetor 2024, janë raportuar 3 raste me HIV/AIDS. Dy raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe një rast gjinisë femërore. Sipas komunave: 2 raste nga Ferizaj; një rast i gjinisë mashkullore i takon grup moshës 25-34 vjeç dhe një rast i gjinisë femërore me grup moshës 50+ si dhe rasti i tretë nga komuna e Podujevës me grup moshës 15-24 vjeç.

Rastet rrugën e transmissioinit të infeksionit e kanë heteroseksuale. Dy raste janë nën ARV dhe janë të raportuara nga ana e Kl. Infektive me anë të formës individuale. Rasti i tretë është dërguar për konfirmim nga ana e QKTGj.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht Transmivive (IST), dhjetor 2024

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar gjithsej 12 raste me Infeksione Seksualisht Transmivive. Rastet e raportuara janë nga komunat: Prishtinë 5, Lipjan 4, Gjilan 2 dhe Ferizaj 1. Sipas diagnozës: Condyloma 10 raste, Chlamydia 1 rast dhe Gonorreja 1 rast. Sipas gjinisë: 3 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 9 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 6 raste, grup moshës 15-24 vjeç 4 raste dhe dy raste janë mbi 50+ vjeç.

Rastet e HIV infeksionit:

- Laboratori referent në IKShPK për HIV e ka kryer konfirmimin laboratorik dhe raportimi i rezultatit është bërë me anë të postës elektronike, përderisa raportimi nga ana e Kl. Infektive është kryer me anë të Formës raportuese me letër dhe janë sjell në dorë.

Rastet e IST-ve të raportuara nga Klinika e Dermatovenerologjisë janë përmes fletave (formave raportuese) dhe janë sjell në dorë në Njësinë për HIV/AIDS/IST, ndërsa rastet nga QRSHP Pejë janë raportua përmes postës elektronike.

Asnjë rast i HIV infeksionit apo IST deri me tani nuk është raportuar me SMSN.

Hepatit akut B dhe C

Gjatë muajit dhjetor, është raportuar 1 rast me Hepatit fulminans B, (Mb. 0.06/100.000 banorë), nga komuna e Prizrenit, e gjinisë femërore, 44 vjeçe.

Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, dhjetor 2024

Tabela 2.

| Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, dhjetor 2024 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---------------|------|-------|-----------|-----------|-------------|-------------|-----|----------|----------------------|---------------------------|---------------------|---------------------|-----------|--------------|--------------------|---------------------|----------|-----------|--------------|--|--------------|-----------|--------|-----|-----|----|-------------------------------------|---------------------|--------|--|
| SËMUNDJA | Pneumonia/ARI | SARI | ILI | Diarrheac | Variçella | Influenca A | Influenca B | RSV | COVID-19 | Sindroma meningjeale | | | Parotitis epidemica | Pertussis | Hepatitac. B | Helminet me ushqim | Gastroenterokolitet | Brucella | Tularemia | Salmonelloza | Infeksi onet virale intestinale dhe ato me | Cl.difficile | **Malaria | **Mpox | IST | HIV | TB | Infeksi onet streptokoksikete gr. A | Sëm. tjera ngjitëse | Totali | |
| | | | | | | | | | | Meningitit serosa | Meningit is meningococcia | Meningoencephalitis | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| DEÇAN | 2 | | 108 | 51 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1 | 164 | |
| DRAGASH | 24 | | 105 | 18 | | | | | | | | 1 | | | | | 2 | | | | | | | | | | | | 1 | 151 | |
| DRENAS | 80 | 1 | 234 | 89 | 29 | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 438 | |
| F. KOSOVË | 37 | 1 | 571 | 185 | 27 | 10 | 1 | 1 | | | 1 | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 835 | |
| FERIZAJ | 30 | 2 | 435 | 135 | 4 | 1 | | | 1 | | 3 | | | | | | 1 | | | | | | | | 1 | 2 | 2 | | | 617 | |
| GJAKOVË | 38 | | 192 | 121 | 2 | | | | 1 | 1 | | | | | | 8 | | | | | 2 | | | | | | | 1 | 367 | | |
| GJILAN | 31 | 2 | 935 | 225 | 24 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 2 | | | | | 1220 | |
| GRAÇANICË | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| H. I ELEZIT | 19 | | 104 | 22 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 145 | |
| ISTOG | 13 | | 251 | 34 | | 1 | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 300 | |
| JUNIK | 0 | | 51 | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 57 | |
| KAÇANIK | 1 | | 57 | 28 | 16 | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 103 | |
| KAMENICË | 0 | | 693 | 94 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 788 | |
| KLINË | 22 | | 190 | 105 | 11 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 2 | 330 | | |
| KLLOKOT | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| LEPOSAVIQ | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| LIPJAN | 3 | | 144 | 49 | 13 | 1 | | 2 | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | 4 | | | | | 217 | |
| MALISHEVË | 18 | | 275 | 106 | 23 | 5 | | | | | | 1 | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 429 | |
| MAMUSHË | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| MITROVICË | 93 | 1 | 722 | 428 | 28 | 1 | | | 1 | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | 4 | 1279 | | |
| MITROVICË E VERIUT | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| N. BËRDË | 0 | | 32 | 16 | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 48 | |
| OBILIQ | 12 | | 247 | 67 | 31 | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 360 | |
| PARTESH | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| PEJË | 15 | | 887 | 271 | 37 | | 1 | 4 | | | | 1 | | | 2 | 1 | 1 | | | | | | | | | | | 5 | 1225 | | |
| PODUJEVË | 8 | | 482 | 88 | 8 | 3 | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | 1 | | 2 | 593 | | |
| PRISHTINË | 1233 | 12 | 3420 | 1178 | 118 | 43 | 5 | 21 | 1 | 3 | | | | 1 | | | 15 | 1 | | 1 | 11 | 1 | 1 | 1 | 5 | | 1 | | 6072 | | |
| PRIZREN | 44 | 3 | 844 | 320 | 43 | | | 1 | | | | 1 | | 1 | 1 | 5 | 13 | | | | | | | | | 2 | 2 | 5 | 1285 | | |
| RAHOVEC | 30 | | 79 | 55 | 1 | 1 | | | | | | | | | | 3 | 5 | | | | | | | | | | | | | 174 | |
| RANILUG | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| SHTËRPCE | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| SHTIME | 16 | | 260 | 14 | 2 | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | 1 | | | 294 | |
| SKËNDERAJ | | 1 | 138 | 65 | 33 | 1 | | 2 | | | | 1 | | | | | | | 1 | | | | | | | | | 1 | 243 | | |
| SUHAREKË | 25 | | 282 | 113 | 2 | | | | | | | 1 | | | | | 4 | | | | | | | | | | | 2 | 429 | | |
| VITI | 2 | | 281 | 194 | 9 | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 487 | |
| VUSHTRRI | 73 | | 39 | 80 | 14 | 6 | | 2 | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | 215 | |
| Z. POTOK | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| ZVEÇAN | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| PA ADRESË | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| TOTALI | 1869 | 23 | 12058 | 4157 | 478 | 78 | 7 | 37 | 3 | 9 | 2 | 3 | 3 | 4 | 1 | 8 | 50 | 9 | 1 | 2 | 13 | 1 | 1 | 1 | 12 | 3 | 5 | 5 | 22 | 18865 | |

*Sëmudjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza, Adenovirus, Enterovirus

**Raste të importuara- Malaria, Mpox

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT DHJETOR 2024

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar dhe rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit dhjetor 2024

Tabela 3.

| Sëmundja | Rastet |
|-------------------------------|------------|
| Pneumonia /ARI | 186 |
| SARI | 23 |
| ILI | 16 |
| Diare dhe gastroenterokolitet | 130 |
| Variçella | 8 |
| Influenca A | 68 |
| Influenca B | 5 |
| RSV | 31 |
| Adenovirus | 12 |
| Sindroma meningjeale | 14 |
| Hepatitis B | 1 |
| Helmimet me ushqim | 16 |
| Brucelloza | 4 |
| Tularemi | 1 |
| Salmonelloza | 2 |
| Malarie | 1 |
| Mpox | 1 |
| Herpes Zooster | 1 |
| Mononucleosis | 4 |
| Erysipela | 4 |
| Exanthema | 5 |
| Total | 533 |



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT DHJETOR, 2024

Epidemia familjare me Brucellozë në fsh. Nagavc, Rahovec

Epidemia familjare me Brucellozë në fsh. Nagavc komuna e Rahovecit, ka filluar më datë 05.12.2024 dhe është konfirmuar më datë 10.12.2024 në laboratorin e mikrobiologjisë në QRShP Prizren. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kuptohet se kanë qenë 5 persona të ekspozuar dhe të gjithë rezultuan pozitiv në ASHB dhe Wright.

Fillimisht pacientët kanë kërkuar shërbime mjekësore në repartin infektiv në Spitalin rajonal Prizren me shenja klinike si: plogështi, lodhje, temperaturë, dhimbje koke, dhimbje shpine. Rastet në fjalë nuk hospitalizohen por trajtohen në mënyrë ambullantore. Kjo familje ka pasur kontakt të drejtëpërdrejtë me kafshë, rreth 180 krerë dele dhe të gjitha janë asgjësuar nga inspektoriati veterinar i AUV më datë 02.12.2024 (QRShP Gjakovë nuk ka pasur asnjë informatë nga AUV për asgjësimin e kafshëve).

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 30 komuna ose 78.9% (30/38) e tyre.

Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.


6. COVID-19

Gjatë muajit dhjetor 2024, janë testuar 631 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe prej tyre janë raportuar 3 raste pozitive me SARS-CoV-2 me një shkallë të pozitivitetit prej 0.47%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 (51 raste pozitive të raportuara), vërehet një ulje prej 94.1% e rasteve të raportuara. Gjatë muajit dhjetor 2024 nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19. (Grafikoni 1). Rastet pozitive, sipas komunave me nga një rast: Ferizaj, Prishtinë dhe Gjakovë.

Sipas grup-moshës, numri i rasteve pozitive me COVID-19 është si vijon: me nga 1 rast grup-moshat: 0-9, 50-59 dhe 70-79 vjeç kurse sipas Incidencës specifike, grup moshë më e prekur, 70-79 me 1.2/100,00 banorë. Sipas gjinisë, 1 rast (33%) nga gjinia femërore dhe 2 raste (67%) të gjinisë mashkullore.

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detekttime) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detekttime). Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të të gjitha shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, dhjetor 2024



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, DHJETOR 2024

Transmetimi i virusit të lisë M clade I në regjionin e Evropës

Rastet e para të konfirmuara të virusit të lisë M (MPXV) clade I midis kontakteve të ngushta të rasteve të importuara brenda BE/ZEE, janë raportuar nga Gjermania dhe Belgjika. ECDC është në kontakt me autoritetet kombëtare të shëndetit publik në këto vende në lidhje me këtë zhvillim të fundit. Rreziku i përgjithshëm për popullsinë e BE/ZEE mbetet i ulët, siç vlerësohet në vlerësimin e shpejtë të rrezikut të publikuar nga ECDC më 16 gusht 2024.

Siç raportohet në përditësimin epidemiologjik të ECDC-së, njëmbëdhjetë raste me clade I MPXV janë raportuar në BE/EEA që nga gushti 2024. Një rast u raportua nga Suedia në gusht 2024, shtatë nga Gjermania (një në tetor, pesë në dhjetor 2024 dhe një në janar 2025), dy raste nga Belgjika në dhjetor 2024 dhe një rast nga Franca në janar 2025. Sëmundja ishte me simptoma të lehta në të gjithë individët. Midis rasteve në Gjermani, një grup i raportuar në dhjetor 2024, përfshinte një rast që kishte udhëtuar në një zonë të prekur dhe tre anëtarë të familjes së tyre, duke përfshirë fëmijë, të cilët nuk kishin udhëtuar jashtë vendit kohët e fundit. Nuk u raportua asnjë transmetim përtej familjes. Në Belgjikë, një fëmijë i prekur ishte një kontakt familjar i një individi të prekur me një histori udhëtimi në një vend të prekur. Përveç rasteve të raportuara në BE/EEA, disa vende jashtë kontinentit afrikan kanë raportuar gjithashtu raste të lidhura me udhëtimet. Vetëm Mbretëria e Bashkuar dhe Kina kanë raportuar transmetim dytësor të mpox për shkak të MPXV clade I jashtë BE/ZEE dhe Afrikë. Informacioni i përditësuar mbi epidemiologjinë dhe modelet e transmetimit të mpox për shkak të klasit I mund të gjendet në Raportin javor të Kërcënimeve të Sëmundjeve Ngjitëse.

Tendencat e infeksioneve akute respiratore, përfshirë metapneumovirusin, në hemisferën veriore

Në shumë vende të hemisferës veriore, rastet e infeksioneve akute respiratore po rriten në këtë periudhë të vitit. Këto rritje zakonisht shkaktohen nga epidemitë sezonale të patogjenëve respiratorë si gripit sezonal, virusi sincicial respirator (RSV) dhe viruset e tjera të zakonshme respiratore, duke përfshirë metapneumovirusin (hMPV), si dhe mycoplasma pneumoniae. Shumë vende bëjnë mbikëqyrje rutinë për infeksionet akute respiratore dhe patogjenët e zakonshëm respiratorë. Aktualisht, në disa vende në hemisferën veriore, numri i rasteve të sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute respiratore (ARI) janë rritur javët e fundit dhe janë mbi nivelet bazë, duke ndjekur tendencat e zakonshme sezonale. Aktiviteti i gripit sezonal është rritur në shumë vende të hemisferës veriore. Aty ku janë raportuar të dhënat e mbikëqyrjes, tendencat në detektimet e RSV ndryshojnë aktualisht sipas rajonit me ulje të raportimit në shumicën e rajoneve me përjashtim të Amerikës së Veriut. Kohët e fundit, ka pasur rritje për rastet e hMPV në Kinë, duke përfshirë raportimet se spitalet janë të mbingarkuar. hMPV është një virus i zakonshëm respirator që qarkullon në shumë vende nga dimri deri në pranverë, megjithëse jo të gjitha vendet testojnë dhe publikojnë në mënyrë rutinore të dhëna për rastet e hMPV. Ndërsa disa raste mund të shtrohen në spital me bronkit ose pneumoni, shumica e njerëzve të infektuar me hMPV kanë simptoma të lehta të frymëmarrjes të ngjashme me ftohjen e zakonshme dhe shërohen pas disa ditësh. Bazuar në të dhënat e publikuara nga Kina, që mbulojnë periudhën deri më 29 dhjetor 2024, infeksionet akute të frymëmarrjes janë rritur gjatë javëve të fundit dhe rastet e gripit sezonal, rinovirusit, RSV dhe hMPV, veçanërisht në provincat veriore të Kinës, janë rritur gjithashtu. Rritja e vërejtur në zbulimin e patogjenëve respiratorë është brenda kufijve të pritur për këtë periudhë të vitit gjatë dimrit të hemisferës veriore. Në Kinë, gripit është patogjeni më i zakonshëm që prek aktualisht njerëzit me infeksione akute respiratore. OBSH është në kontakt me zyrtarët kinezë të shëndetësisë dhe nuk ka marrë asnjë raport për modele të pazakonta shpërthimi. Autoritetet kineze raportojnë se sistemi i kujdesit shëndetësor nuk është i mbingarkuar dhe nuk ka pasur deklarata emergjente apo përgjigje. Sipas ECDC, hMPV qarkullon rregullisht në BE/EEA gjatë muajve më të ftohtë. Aktualisht,

mbikëqyrja e infeksioneve akute respiartore në BE/ZEE tregon rritje të aktivitetit të viruseve respiraore, veçanërisht të gripit, pa asnjë model të pazakontë ose të papritur për këtë periudhë të vitit.

OBSH dhe ECDC vazhdojnë të monitorojë infeksionet respiratore në nivel global, rajonal dhe vendor përmes sistemeve bashkëpunuese të mbikëqyrjes dhe ofron përditësime sipas nevojës.

Sëmundjet zoonotike në rritje në BE: rastet e listeriozës kanë arritur nivelin më të lartë që nga viti 2007

Numri i rasteve humane të raportuara të listeriozës (2,952) tregoi një rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2019-2023, duke arritur nivelet më të larta që nga viti 2007. Kjo mund të lidhet me plakjen e popullsisë së Evropës - 21.3% e evropianëve tani janë mbi 65 vjeç - e cila, në lidhje me përhapjen në rritje të sëmundjeve kronike të lidhura me moshën, rrit rrezikun e simptomave të rënda në grupmoshat më të mëdha. Gjithashtu, Kampilobakterioza dhe Salmoneloza ishin sëmundjet zoonotike më të shpeshta të raportuara te njerëzit në BE. Në vitin 2023, u raportuan 148,181 raste të kampilobakteriozës, duke shënuar një rritje nga 139,225 në 2022.

Një Shëndet është një qasje multi-sektorale që synon të balancojë dhe optimizojë shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit të tyre të përbashkët, duke njohur ndërlidhjen e tyre. Duke promovuar veprime të përbashkëta, Një Shëndet bashkon profesionistë nga disiplina të ndryshme për të trajtuar kërcënimet komplekse shëndetësore në një mënyrë të integruar.

EFSA po publikon një përmbledhje në gjuhë të thjeshtë (PLS) - një version i thjeshtuar i Raportit të Zoonozave të Bashkimit Evropian One Health 2023 të EFSA, së bashku me hartat e historive dhe tabelat e kontrollit që lejojnë përdoruesit të kërkojnë dhe vizualizojnë të dhëna për shpërthimet e shkaktuara nga ushqimi dhe 14 patogjenë zoonotikë. Veçanërisht, gjashtë harta historish dhe katër tabela janë publikuar për herë të parë për Echinococcus, ethet Q, tërbimin, Toxoplasma gondii, Trichinella, Tularemia, virusi i Nilit Perëndimor dhe Yersinia.

8. REKOMANDIMET

Në funksion të pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në Kosovë, sëmundjet ngjitëse duhet të raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës në kohë reale, në mënyrë që informata kthyesë dhe përgjigja epidemiologjike të jetë me kohë.

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit/raportimit të sëmundjeve ngjitëse në të gjitha Institucionet shëndetësore.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë bashkëpunimin ndërsektorial dhe themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**

